



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 614/5 prot.

Datë 20.03.2024

V E N D I M
Nr. 290/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.03.2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-97596-03-07-2024, me objekt: “Blerje tonera për printera dhe fotokopje për vitin 2024”, me fond limit 1.500.000.lekë pa TVSH, parashikuar per t’u zhvilluar më datë 20.03.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vau Dejës.

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit.

Ankimues: Operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK me NIPT K21605003M dhe adresë: Autostrada Tiranë-Durrës, Km.09, Kashar, Tiranë.

Operatori ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK me NIPT L82428011G dhe adresë, Rruga: “Fortuzi 66/1”, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Vau Dejës.
Adresa: Rruga Qafa e Gurit, Vau Dejës.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik

Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”. Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.5. Operatorët ekonomikë ankimues, kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 08.03.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me REF-97596-03-07-2024, me objekt: “Blerje tonera për printera dhe fotokopje për vitin 2024”, me fond limit 1.500.000.lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 20.03.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vau Dejës.

II.2. Në datën 11.03.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si edhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankesa e operatorit ekonomik “Interlogistic” SHPK, me nr. 614/2024 prot., datë 11.03.2024 dhe me numër ankimi elektronik A/2024/3888, datë 11.03.2024, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi.

II.2.1. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.2.2. Nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, Vendimi i autoritetit kontraktor nr.1229/6 prot., datë 18.03.2024, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues për procedurën e mësipërme të prokurimit, protokolluar me tonën me nr. 614/2, datë 18.03.2024. Referuar këtij vendimi rezulton, se autoriteti kontraktor ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe ka vendosur pranimin plotësisht të ankesës si më poshtë:

[...] Pretendimi nr I

2.2.3. *Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2024 sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete. (Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Shtojcës 8. Operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara shpalljes fitues, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimin e shlyerjes së taksave vendore).*

Në lidhje me këtë kriter peretendojmë se është vendosur gabim nga ana e AK-së, pasi çdo subjekt juridik privat ka afat kohor deri me datë 30.04.2024 për pagesën e detyrimeve dhe taksave vendore...

Bëhet

Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2023 sipas Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete. (Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Shtojcës 8. Operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara shpalljes fitues, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimin e shlyerjes së taksave vendore).

Pretendimi nr.2

Në lidhje me kriterin që “OE duhet të deklarojë se tonerat duhet të jenë original, jo kompatibël, jo të ricikluar, jo të manifaturuar?...” kriter i vendosur për të gjithë llojet e tonerave të kërkuar nga ana e Juaj, kërkojmë që ky specifikim të ndryshohet/modifikohet duke shtuar fjalën ekuivalent

Bëhet

OE duhet të deklarojë se tonerat të jenë origjinal ose ekuivalente, jo kompatibel, jo te ricikluar, jo te manifaturuar, duhet të deklarojë se Tonerat janë sipas kapaciteteve të kerkuara

Pretendimi nr.3

Në lidhje me kriterin “OE duhet te deklaroje se emri i kompanise te tonerit, eshte i stampuar (jo etikete e ngjitur) dhe i njejte, ne paketim ne pjesen plastike dhe ne pullen e sigurise.

Në lidhje me togëfjalëshin “dhe në pullën e sigurisë” pretendojmë se vendosja e një kriteri të tillë nuk është i përshtatshëm për arritjen e synimit të autoritetit kontraktor, për verifikimin e përputhshmërisë së produkteve

Bëhet

OE duhet te deklaroje se emri i kompanise te tonerit, eshte i stampuar (jo etikete e ngjitur) dhe i njejte, ne paketim ne pjesen plastike

II.3. Në datën 13.03.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si edhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankesa e operatorit ekonomik “BluePrint Technologies” SHPK, me nr. 649/2024 prot., datë 18.03.2024 dhe me numër ankimi elektronik A/2024/3902, datë 13.03.2024, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi.

II.3.1. Nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, Vendimi i autoritetit kontraktor nr.1229/6 prot., datë 18.03.2024, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues për procedurën e mësipërme të prokurimit, protokolluar me tonën me nr. 614/2, datë 18.03.2024. Referuar këtij vendimi rezulton, se autoriteti kontraktor ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe ka vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesave, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Interlogistic”SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, Vendimi i autoritetit kontraktor nr.1229/6 prot., datë 18.03.2024, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues për procedurën e mësipërme të prokurimit, protokolluar me tonën me nr. 614/2, datë 18.03.2024. Referuar këtij vendimi rezulton, se autoriteti kontraktor ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe ka vendosur pranimin plotësisht të ankesës si më poshtë:

[...] Prendimi nr I

2.2.3.Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2024 sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete. (Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Shtojcës 8. Operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara shpalljes fitues, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimin e shlyerjes së taksave vendore).

Në lidhje me këtë kriter peretendojmë se është vendosur gabim nga ana e AK-së, pasi çdo subjekt juridik privat ka afat kohor deri me datë 30.04.2024 për pagesën e detyrimeve dhe taksave vendore...

Bëhet

Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2023 sipas Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi

operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete. (Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Shtojcës 8. Operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara shpalljes fitues, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimin e shlyerjes së taksave vendore).

Pretendimi nr.2

Në lidhje me kriterin që “OE duhet të deklarojë se tonerat duhet të jenë original, jo kompatibël, jo të ricikluar, jo të manifaturuar?...” kriter i vendosur për të gjithë llojet e tonerave të kërkuar nga ana e Juaj, kërkojmë që ky specifikim të ndryshohet/modifikohet duke shtuar fjalën ekuivalent

Bëhet

OE duhet të deklarojë se tonerat të jenë origjinal ose ekuivalente, jo kompatibel, jo te ricikluar, jo te manifaturuar, duhet të deklarojë se Tonerat janë sipas kapaciteteve të kerkuara

Pretendimi nr.3

Në lidhje me kriterin “OE duhet te deklaroje se emri i kompanise te tonerit, eshte i stampuar (jo etikete e ngjitur) dhe i njejte, ne paketim ne pjesen plastike dhe ne pullen e sigurise.

Në lidhje me togëfjalëshin “dhe në pullën e sigurisë” pretendojmë se vendosja e një kriteri të tillë nuk është i përshtatshëm për arritjen e synimit të autoritetit kontraktor, për verifikimin e përputhshmërisë së produkteve, k

Bëhet

OE duhet te deklaroje se emri i kompanise te tonerit, eshte i stampuar (jo etikete e ngjitur) dhe i njejte, ne paketim ne pjesen plastike

III.1.2. Neni 30 i LPP-së, parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.1.3. Neni 114 i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.*

Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

2. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.

3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:

- a) pranimin e plotë të ankesës;
- b) pranimin e pjesshëm të ankesës;
- c) refuzimin e ankesës.

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor, të kryera në zbatim të vendimit të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik.

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se : “1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.5. Sa më sipër, nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, nga verifikimi i vendimit të autoritetit kontraktor nr.543/8 prot., datë 28.02.2024, protokolluar me tonën me 426/3 prot., datë 28.02.2024, konstatohet se ky i fundit, ka vendosur pranim plotësisht të ankesës së operatorit ekonomik “Interlogistic” SHPK, kështu që rrjedhimisht Komisioni do të mbyllë çështjen në lidhje me këto pretendime, për sa kohë ato janë pranuar nga vetë autoriteti kontraktor.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “BluePrint Technologies” SHPK, për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, duke kërkuar, “Kërkesa për bilancet 2020-2022, përcaktuar në pikën 2.2.1 të kriterëve të kualifikimit, duhet të hiqet”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Autoriteti Kontraktor në Shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” pika 2.2.1, ka parashikuar si më poshtë:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2020, 2021, 2022) të certifikuar nga organet tatimore. Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

III.2.2. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit”, 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *“Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”.*

III.2.3. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën”.*

III.2.4 Në nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi”.*

III.2.5 Në nenin 43, “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare .*

2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:*
a) *dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar*
b) *vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.*
3. *Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*
4. *Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit .*
5. *Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*
6. *Në çdo rast, kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës*

III.2.6. Në nenin 55 “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, pika 4 e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “[...]Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.[...]”

III.2.7. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në rastin konkret KPP konstaton, se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertues zotërojnë kapacitetet e ekonomike të nevojshme për realizimin e kontratës. Në këtë kuadër KPP, vëren se për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit krahas paraqitjes nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm, kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, edhe kopje të certifikuara nga organet tatimore të bilanceve të viteve (2020, 2021, 2022). Sa më sipër, referuar llojit të procedurës së prokurimit e konkretisht “procedurë e hapur e thjeshtuar”, legjislacioni parashikon që autoritet/entet kontraktore duhet të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Në këtë kuptim, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në frymën e ligjit, duhet

të marrë masa për të hequr kriterin e kërkesës së dorëzimit të kopjeve të bilanceve të certifikuara, që plotësimi i këtyre kërkesave të mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “BluePrint Technologies” SHPK “Në pikën 2.2.3 kërkohet: **2.2.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2024 sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete. (Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Shtojcës 8. Operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara shpalljes fitues, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimin e shlyerjes së taksave vendore)...Për këtë arsye kërkojmë që kjo kërkesë të ndryshojë dhe të pranohet vërtetim i lëshuar nga E-Albania, në lidhje me taksat vendore” KPP gjykon, se ky pretendim në thelb ka të bëjë me shtim të kriterëve të kualifikimit dhe jo me pretendime për modifikimin e kriterëve, diskriminuese, të cilat do të shkaktonin skualifikim të padrejtë nga procedura e prokurimit. KPP gjykon, se ka një ndarje të qartë mes rolit të tij të paraparë nga ligji, si organi më i lartë i shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimeve publike (neni 24 e vijues i LPP-së) dhe autoriteteve kontraktore si organ përgjegjës i zhvillimit të procedurave të prokurimit (neni 21 i LPP-së) dhe njëherazi përgjegjës për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik. Në nenin 110 pika 1 të LPP-së, parashikohet, se “Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë”. KPP gjykon, se që të justifikohet ligjërish kërkitimi për njohjen ose rivendosjen e një të drejte të shkelur ose të mohuar duhet që të bëhet vetëm prej atij që i përket, sipas ligjit, e drejta e mohuar ose e shkelur prej një të treti dhe vetëm kundër atij që me faktin ose me veprën e tij mohon ose shkel të drejtën e kërkuar (legjitimimi pasiv), duke justifikuar me këtë fakt ose veprim ndërhyrjen e organit administrativ, për të ndaluar ose për të zhdukur dëmin e rrjedhur nga ky fakt, ose veprimeve, pra operatori ekonomik ankimues duhet të provojë se interesi i tij i ligjshëm është cenuar nga vendime dhe veprime konkrete (reale) të autoritetit kontraktor. Në rastin konkret, KPP gjykon, se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar mekanizmat ligjorë për kundërshtimin e kriterëve për kualifikim pranë këtij të fundit, duke i dhënë garanci të plota operatorëve ekonomikë ankimues, se procedurat për fitimin e kontratave publike, do t'i nënshtrohen kushteve specifike, të cilat duhet të përmbushin parakushtin e parashikuar nga neni 77 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”. Në rastin konkret, KPP gjykon, se njësia e prokurimit pranë autoritetit kontraktor ka parashikuar kriterin minimal, të gjykuar të nevojshëm për vërtetimin e plotësimin të kapacitetit teknik të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, për realizimin me sukses të kontratës objekt - prokurimi. Kuadri ligjor në fuqi, ka paraparë pozitën juridike të Komisionit të Prokurimit Publik, si organ i shqyrtimit të ankesave kundër vendimeve të shprehura me akte administrative (dokumentet e procedurës së prokurimit), duke i dhënë të drejtën ligjore të shprehet mbi kriteret kualifikuese dhe specifikimet teknike në rast se këto të fundit janë hartuar në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe kuadrin ligjor sektorial në fuqi që rregullon kontratën objekt-

prokurimi. Komptenca e mësipërme është shprehur në disa drejtime në ligjin për prokurimin publik në fuqi, ku nën nenin 118 pika 2 gërma “b” të lex specialis parashikohet, se ndër kompetencat e Komisionit të Prokurimit Publik, janë ato të anulimit, plotësisht ose pjesërisht, të një veprimi ose vendimi të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato kritere kualifikimi ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj. Në rastin konkret, KPP gjykon, se objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimues nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor (verifikimin ligjor në rast se kriteri i kualifikimit është në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës, apo në rast se kriteret e kualifikimit janë hartuar në formën e kërkuar nga ligji), por mbi shtimin e kriterëve të kualifikimit në një procedurë prokurimi, pasi përcaktimi i kriterëve të kualifikimit sipas kërkesës nga ankimuesi, konsiderohen kritere të reja që do të rëndonin pozitën e operatorëve ekonomikë të interesuar. Sa më sipër, KPP gjykon, se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar, se është në të drejtën e plotë të autoritetit kontraktor të parashikojë kriteret minimale në një procedurë prokurimi dhe në rast se këto të fundit, (vetëm kriteret të shprehura dhe jo ato hipotetike të kërkuara) nuk janë në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi, jepet garancia procedurale e paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Sa më sipër, për sa kohë që autoriteti kontraktor nuk ka gjykuar të vendosë kriteret e kualifikimit sipas propozimit të operatorit ekonomik ankimues, KPP në asnjë rast nuk mund të marrë kompetencat e autoritetit kontraktor (njësisë së prokurimit), të shtojë kritere kualifikimi në një procedurë të prokurimit publik.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “BluePrint Technologies” SHPK, “ *Ne piken 2.4.2 ndër të tjera kërkohet: b) OE duhet të deklarojë se emri i kompanisë të tonerit, është i stampuar (jo etiketë e ngjitur) dhe i njejtë, në paketim në pjesën plastike dhe në pullën e sigurisë. c) Për të vertetuar origjinalitetin e tonerave do të behet kontrolli nëpërmjet barkodit në internet.*

2 kërkesat më sipër nuk janë në përputhje me LPP dhe VKM për RPP..., kërkojmë që pika b dhe c më sipër të hiqen nga kriteret e kualifikimit si të pambështetura në ligj”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.1. Autoriteti Kontraktor në Shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.4.2, ka parashikuar si më poshtë:

2.4.2 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se:

- *Operatori ekonomik duhet të deklarojë se mallrat që do të dorëzoje do të jenë të njëjtë me mostrat e paraqitura ditën e zhvillimit të procedurës së prokurimit.*
- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të cilës merr përsipër të kryerje shërbimin e transportit të të gjithë artikujve të kërkuar në adresën e autoritetit kontraktor.*
- *OE duhet të deklarojë se tonerat të jenë origjinal, jo te ricikluar, jo te manifaturuar, duhet të deklarojë se deklarojë se Tonerat janë sipas kapaciteteve të kerkuara*
- *OE duhet te deklaroje se emri i kompanise te tonerit, eshte i stampuar (jo etikete e ngjitur) dhe i njejte, ne paketim ne pjesen plastike dhe ne pullen e sigurise.*
- *Per te vertetuar origjinalitetin e tonerave do te behet kontrolli nepermjet barkodit ne internet..*

III.4.2. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit”, 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *“Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”.*

III.4.3. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën”.*

III.4.4 Në nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi”.*

III.4.5 Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

III.4.6. Në nenin 40, pika 3 dhe 6 të VKM nr.285 dt 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikon se: *3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- a) *mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose*
- b) *fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose*
- c) *dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.*

III.4.7. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik, duke mos i tejkualuar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit.

Referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimes për heqjen e kërkesave të përcaktuara në pikën b dhe c të kriterit 2.4.2, të dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në faktin, nëse kërkesat janë në proporcion me objektin e kontratës që do të prokurohet, në zbatim të nenit 77, pika 1 të LPP-së. Në rastin konkret KPP konstaton, se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi, se subjektet ofertuese, zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës, duke ofruar produkte që përmbushin specifikimet teknike të përcaktuara nga ana e entit prokurues. KPP konstaton, se për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, jo vetëm kriteret kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik, por edhe kriteret të tjera kualifikimi, të cilat lidhen me vërtetimin e plotësimin të specifikimeve teknike të produktit, me anë të dorëzimit të mostrave të mallrave objekt - prokurimi. KPP gjykon, se kërkesa e autoritetit kontraktor *që emri i kompanisë së tonerit të jetë i stampuar dhe i njëjtë në paketim, në pjesën plastike dhe në pullën e sigurisë dhe kërkesa mbi vërtetimin e origjinalitetit të tonerave nëpërmjet kontrollit të barkodit në internet*, janë kërkesa të ekzagjeruara dhe shkojnë përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit. Për këtë arsye, autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e dokumenteve të

tenderit të procedurës objekt - ankimi, duke i hequr këto kërkesa të përcaktuara në pikën b dhe c të kriterit 2.4.2, të Shtojcës 7, të dokumenteve të tenderit.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen, për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-97596-03-07-2024, me objekt: “Blerje tonera për printera dhe fotokopje për vitin 2024”, me fond limit 1.500.000.lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 20.03.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vau Dejës.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “BluePrint Technologies” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse, për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK dhe operatori ekonomik “BluePrint Technologies” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

